

UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Qeverisja e Korporatave

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Qeverisja e Korporatave
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i VI -rë, semestri i VIII-të
Numri i orëve në javë:	3 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Gani ASLLANI
Asistent:	
Detajet kontaktuese:	Emaili: ganiasllani@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Njoftimi, përgaditja dhe aftësimi i juristeve të ardhshëm, të atyre që punojnë në Institucione por edhe në sektorin privat, që i referohen fushës financiare, që zbatojnë metodat më të përshtatshme dhe më adekuate për zgjidhjen e problemeve nga kjo fushë. Aftësimi për interpretimin e dispozitave juridike nga fusha e funksionimit të korporatave, qeverisjes së tyre, pjesëmarrjes në investime dhe ndarjes së fitimit dhe çështjeve tjera juridiko financiare.
Qëllimet e lëndës:	Fitimi i njohurive bazë, elementeve dhe veçorive të Qeverisjes së Korporatave, praktikave të funksionimit, themelimit, organizimit dhe çështje tjera të funksionimit të tyre në ekonomi të tregut. Në këtë modul do të trajtohen çështje si p.sh: përkufizimi i korporatave, zhvillimi historik i tyre, menaxhimi i korporatave, investimet dhe ndaja e fitimit, korporota dhe mejdisi social, modelet e qeverisjes, organet e korporatave, raportimet dhe kontrolli i punës, përgjegjësitë e anëtarëve të korporatës, funksionimi i korporatave në Kosovë, ligjet bazike që rregullojnë funksionimi të tyre dhe të tjera. Gjithashtu studentët do të fitojnë njohuritë bazë sa i përket rasteve konkrete të funksionimit të disa nga korporatave më të njohura në vendet e zhvilluara, por edhe të funksionimit të tyre në shtetet e tranzicionit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	1. Marrin informacione dhe njohuri të mjaftueshme mbi të korporatata dhe qeverisjen e tyre;

	2. Kuptojnë rendësinë e funksionimit të korporatave në zhvillimin ekonomik dhe ekonominë e tregut: 3. Njoftohen me fushat bazë dhe specifike e qeverisje së korportave, investimet dhe rreziqet në investime: 4. Njohjen me ligjet bazë që rregullojne funksionimin e korprotave, shoqërisë akcionare dhe çështjet tjera të themelimit dhe organizimit të tyre: 5. Përfitojnë njohuri shtesë për ligjet të cilët mund të ndikojnë në korporata, regjistrimin e tyre, tatimimin dhe specifikat tjera të kësaj fushe.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Kollokfiume,seminare	4	5	20
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	3	10	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	5	5
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	3	10	30
Totali			210
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike, Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë temë apo punimi seminari. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve te tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund behet vlerësimi i punimit.		

	Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose më shumë grupe, me qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane: prezantimi i temës përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjëruar. Në disa raste atyre do të prezantohen edhe ligjërata autentike nga universitetet e ndryshme perëndimore.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 25 pikë Testi i dytë: 25 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë (5 detyra x 2 pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 30 pikë <u>Totali: 100 pikë.</u> Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	- Shyqri Llaci & Jorida Tabaku, Qevrerisja e Korporatave, Tiranë, 2009. - Gazmend Luboteni, Financat e Korporatave, Prishtinë, 2006 - Gazmend Luboteni, Financat e Korporatave, Prishtinë, 2005
Literatura shtesë:	- A. Th. Donaldson & L. Peterson (1995) "The stockholders theory of the corporation concepts, evidence and implementation" Academic and Management Review. - A. Chandler (1977) "The visible hand-The managerial revolution in American Business". - Ch.Oman (2001) "Corporate governance and national development" OECD, Paris. - Vilim Gorenc, "Bazat e së drejtës tregtare statusore dhe kontraktuale" Zagreb, 2003, Përkthim në gjuhën shqipe, Kolegji Victory, Prishtinë. - Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (G.Z. Nr. 39, 1 tetor 2008); Ligji Nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (G.Z. Nr. 6, 22 korrik 2011). - Arman Krasniqi, Leksione, "E drejta Biznisore

	ndërkombëtare”, 2011.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i programit, hyrje në Qeverisjen e Korporatave
<i>Java e dytë:</i>	Historiku i zhvillimit të Korporatave
<i>Java e tretë:</i>	Korporata dhe mjedisi social
<i>Java e katërt:</i>	Teoritë e qeverisjes së Korporatave
<i>Java e pestë:</i>	Rëndësia dhe përmbajtja e korporatave
<i>Java e gjashtë:</i>	Menaxhimi i korporatave, Bordi i drejtorëve
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i Parë
<i>Java e tetë:</i>	Shpërblimet e menaxherve në Korporata
<i>Java e nëntë:</i>	Auditimi dhe qeverisja e Korporatave
<i>Java e dhjetë:</i>	Raportimi financiar dhe zbulimi i informacioneve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Qeverisja e korporatave në vendet e tranzicionit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Qeverisja e korporatave e ndërmarrjeve publike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Dallimet e modeleve të qeverisjes së korporatave
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Funksionimi i Korporatave në Kosovë, aspekti ligjor i rregullimit të tyre.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi Përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshme dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore, - Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore, - Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e kartelës në teste dhe provim, - Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit	